



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet: 143 dhe 145 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohet ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet: 144, 146 dhe 147 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ndryshime Klimatike.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit në mes të Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës, dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin "Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 B".
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/151
Datë: 12.07.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Koordinues për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatën ndërkombëtare Këshilli i Evropës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Z. Kreshnik Ahmeti, Zv. Ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kryesues;
 - 1.2. Përfaqësues nga Zyra e Zv. Kryeministrit, anëtar/e;
 - 1.3. Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, anëtar/e;
 - 1.4. Përfaqësues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, anëtar/e;
 - 1.5. Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar/e;
 - 1.6. Përfaqësues nga Zyra për Qeverisje të Mirë, anëtar/e;
 - 1.7. Përfaqësues nga Agjencia për Barazi Gjinore, anëtar/e;
 - 1.8. Z. Kushtrim Istrefi-Profesor, anëtar.
2. Ftohen Zyra e Presidentes, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, të dërgojnë përfaqësuesit e tyre për të marrë pjesë në këtë Grup Koordinues për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës.
3. Grupi Koordinues, i cekur si në pikën 1. të këtij Vendimi ka për detyrë të zhvilloj komunikimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional lidhur me procesin e anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës (KE), duke shkëmbyer informacione që ndërlidhen me procesin e anëtarësimin në KE dhe duke hartuar raporte për çështje specifike në fazën e përgatitjes së Opinionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës
4. Kryesuesi, sipas nevojës mund të ftoj edhe përfaqësues të institucioneve tjera, në kuadër të takimeve të Grupit Koordinues.
5. Kryesuesi, mund të propozoj edhe angazhimin e ekspertëve të jashtëm për të ndihmuar Grupin Koordinues në aspektin profesional, në kuadër të procesit të anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Arsimit, Grupi Nr. 49 në këtë përbërje:


- 1.1. Zade Kuqi - Zyrtare e Lartë për Politikën e Përshkrimit dhe Klasifikimit të Vendeve të Punës në DMZP/MPB, kryesuese;
- 1.2. Besa Bytyqi, Udhëheqëse e Divizionit për Komunikim me Publikun /MASHTI, anëtare;
- 1.3. Leonita Shabani, Drejtore e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave/ME, anëtare;
- 1.4. Vigan Berisha, Udhëheqës i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/MPJD, anëtar;
- 1.5. Adelina Hajrullahu, Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", anëtare.

Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit.

- 1.1. Minire Gjokaj, Zyrtare për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në DMZP/MPB;
 - 1.2. Valbona Fetiu-Mjeku, Udhëheqëse e Divizionit për Standarde të Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Sigurim të Cilësisë /MASHTI;
 - 1.3. Fazile Bektashi, Udhëheqëse e Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit/ME;
 - 1.4. Taibe Selmani, Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa /MKRS;
 - 1.5. Fitim Humolli, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" .
2. Komisioni i Pranimit për institucionet e administratës shtetërore për Grupin Specialist i Arsimit, Grupi Nr. 49 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka një mandat dy (2) vjeçar.
3. Anëtari nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Arsimit, Grupi Nr. 49 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/151
Datë: 12.07.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Pranimin për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm për Inspektim, Grupi, ad hoc i themeluar nga Ministri përgjegjës për Administratën Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1. Selvete Gjonbalaj, Zyrtare e Lartë për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në DMZP/MPB, kryesuese;
 - 1.2. Arton Çerkini, Udhëheqës i Divizionit të Koordinimit Rajonal në Ferizaj/IP, anëtar;
 - 1.3. Jehona Murati-Dugolli, Menaxhere e Personelit në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë/MBPZhR, anëtare;
 - 1.4. Riza Fazliu, Udhëheqës në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Gjilan, anëtar;
 - 1.5. Genc Hundozi, Organizata të specializuara "Infrakos" anëtar.
- Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit
 - 1.1. Minire Gjokaj, Zyrtare për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në DMZP/MPB;
 - 1.2. Nexhmije Selimi, Drejtore Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshëm /IP;
 - 1.3. Bedri Zyberaj, Drejtor i Departamentit për OJQ/MPB;
 - 1.4. Fadil Kelmendi, Udhëheqës në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Pejë;
 - 1.5. Albana Berisha-Qehaja, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina".
2. Komisioni i Pranimin për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm për Inspektim, Grupi ad hoc i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, ka mandat varësisht kohëzgjatjes së grupit nga ana e Ministrisë përgjegjëse për administratë publike, por jo më shumë se dy (2) vjet.
3. Anëtarin nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm për Inspektim, Grupi ad hoc i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12. të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Pranimin për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore, Grupi Nr. 20 në këtë përbërje:

- 1.1. Shqipe Abdullahu - Zyrtare për Politika të Pagave në DMZP/MPB, kryesuese;
- 1.2. Merita Augustini, Udhëheqëse e Divizionit për Trashëgimi Arkitekturore dhe Arkeologjike/MKRS, anëtare;
- 1.3. Imer Hakaj, Drejtor i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore/MKRS, anëtar;
- 1.4. Taibe Selmani, Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa/MKRS, anëtare;
- 1.5. Artnet Haskuka, Organizata të specializuara "Pro-Planning-Qendra Kosovare për Hulumtime Urbane", anëtare.

Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit.

- 1.1. Selami Osmani, Zyrtar i Lartë për Politika të Trajnimit dhe Zhvillimit në DMZP/MPB;
- 1.2. Vedat Jashari, Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Politikave Rinore/MKRS;
- 1.3. Shkurtë Kadriu, Udhëheqëse e Divizionit të Promovimi të Kulturës/MKRS;
- 1.4. Brikena Mulliqi, Drejtore e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave/MKRS;
- 1.5. Mentor Hasani, Universiteti "Hasan Prishtina" Fakulteti Filozofik.

2. Komisioni i Pranimin për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore, Grupi Nr. 20 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi ka një mandat dy (2) vjeçar.

3. Anëtari nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore, Grupi Nr. 20 i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/151
Datë: 12.07.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 34, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 paragrafi 3. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Posaçëm për Inspektim, Grupi ad hoci i themeluar nga Ministri përgjegjës për Administratën Publike, në këtë përbërje:
 - 1.1. Selami Osmani, Zyrtar i Lartë për Politika të Trajnimit dhe Zhvillimit në DMZP/MPB, kryesues;
 - 1.2. Imer Hakaj, Drejtor i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore/MKRS, anëtar;
 - 1.3. Dijana Dushullovc-Haziri, Udhëheqëse e Divizionit të Inspektimit/AShAK, anëtare;
 - 1.4. Dafina Gashi, Menaxhere e Personelit në Agjencinë Pyjore të Kosovës/MBPZhr, anëtare;
 - 1.5. Skender Loshi, Organizata të specializuara " Sh Architecture" Sh. P. K.
- Përbërja e anëtareve zëvendësues të Komisionit.
 - 1.1. Minire Gjokaj, Zyrtare për Administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Informatave të Burimeve Njerëzore në DMZP/MPB;
 - 1.2. Shpresa Mekaj, Drejtore e Departamentit për Politika Zhvillimore/AShAK;
 - 1.3. Habibe Qovanaj, Udhëheqëse e Divizionit për Bashkëpunim/AShAK;
 - 1.4. Fatmir Kabashi, Udhëheqës i Divizionit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave/MKRS;
 - 1.5. Edlira Qefalija, Universiteti "Kolegji AAB" anëtare.
2. Komisioni i Pranimit për institucionet e administratës shtetërore për Grupin Specialist i Posaçëm për Inspektim, Grupi ad hoc i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, ka mandat varësisht kohëzgjatjes së grupit nga ana e Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike, por jo më shumë se dy (2) vjet.
3. Anëtarë nga pika 1.5 e këtij Vendimi ka të drejtën e kompensimit sipas nenit 20, paragrafit 1. dhe 2. të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Komisioni i Pranimi për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Posaçëm për Inspektim, Grupi ad hoc i emëruar sipas pikës 1. të këtij Vendimi, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Rajonale, R 115 Prizren-Prevallë Zona Kadastrale: Gornje Sellë, Komuna Prizren, sipas tabelës të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: Zgjerimi i Rrugës Rajonale, R 115 Doganaj-Shtërpçë Zonat Kadastrale: Viqë dhe Drekcoc, Komuna Shtërpçë, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për Bashkëpunim në Fushat Ushtarake të Trajnimeve, Teknikës dhe Shkencës.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Kryesisë së Shtabit të Përgjithshëm të Republikës së Turqisë për Bashkëpunim në Trajnimin Ushtarak.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 42 paragrafi 3. dhe 4. të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik dhe nenit 14 të Rregullores Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Anita Kalanderi, emërohet Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë (4) vite.
3. E emëruara nga pika 1. e këtij Vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/151
Datë: 12.07.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë